

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-206/11

Prishtinë, 22 qershor 2012

Në çështjen juridike të:

F.F.

Pala ankuese

Kundër

I.M.

Paraqitësi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Antarë, duke vendosur lidhur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/100/2011 (lënda është regjistruar në AKP me numrin KPA00342), të datës 23 gusht 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 22 Qershor 2012, mori këtë

AKTGJYKIM

1- Refuzohet si e pabazuar ankesa e F.F..

- 2- **Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 80,50 € (tetëdhjetë euro e pesëdhjetë centë), të cilat duhet të paguhen brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përbarimit të detyrueshëm.**

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me 12 shkurt 2007, I.M. ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku ka kërkuar që të njihet si (bashkë)pronar i pronës që gjendet në Miroc në Vushtrri, ngastra nr. 908/4, arë e klasës 3 me sipërfaqe prej 87 m², dhe ka kërkuar ri-posedimin e saj. Ai ka sqaruar se pronën e kishte fituar me trashëgimi, ndërsa e kishte humbur atë me 1 qershor 1999 dhe se humbja e pronës ishte rezultat i rrethanave të viteve 1998/1999 në Kosovë. Kërkesa ishte regjistruar në AKP me nr. KPA00342 Për të mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur në AKP dokumentet e mëposhtme:

- Vendimin mbi trashëgiminë nr. 185/2005, të lëshuar me 16 nëntor 2005 nga Gjykatat Komunale e Vushtrrisë, sipas të cilit I.M. kishte të drejtën në 1/3 e pronës së regjistruar në fletën poseduese nr. 184, të lëshuar nga Republika e Serbisë, Komuna e Vushtrrisë, Gojbulë me 8 shtator 2005, e cila tregon se Z.M.M. ishte në posedim të ngastrës kontestuese nr. 908/4.

Si fleta poseduese nr. 184 ashtu edhe vendimi mbi trashëgiminë kanë mundur të verifikohen.

Me 10 shtator 2007, zyrtarët e AKP-së kanë shkuar në vendin ku supozohej se ndodhej ngastra dhe kanë vendosur një shenjë që tregon se prona ishte objekt i kërkesës dhe se palët e interesuara duhet të paraqisnin përgjigjen e tyre brenda 30 ditëve. Prona është gjetur e pazuruar.

Pasi që vendimi i parë i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) lidhur me pronën kontestuese (KPCC/D/A/2008, të datës 22 shkurt 2008) ishte shfuqizuar, notifikimi ishte përsëritur me 30 gusht 2010, këtë herë duke e publikuar kërkesën në Gazetën Zyrtare të AKP-së nr. 7. Gazeta i ishte dhënë udhëheqësit të fshatit, ishte vendosur në hyrje dhe në dalje të fshatit Gojbulë dhe ishte lënë në disa zyra tjera të institucioneve që merren me çështje pronësore.

Me 23 shkurt 2011, KKPK-ja me vendimin e tij KPCC/D/A/100/2011 ka pranuar kërkesën pasi që paraqitësi i kërkesës e kishte vërtetuar pronësinë mbi pjesën ideale prej 1/3 të pronës së kërkuar. Paraqitësi i kërkesës është dashur të konsiderohej se kishte arritur të fitojë të gjitha të drejtat që i përkasin pronarit.

Vendimi i është dorëzuar paraqitësi të kërkesës me 1 korrik 2011. Të njëjtën ditë, paraqitësi i kërkesës ka kërkuar nga AKP-ja që të marrë pronën nën administrimin e saj.

Me 8 nëntor 2011, F.F. me letrën e datës 21 tetor 2011 ka kërkuar nga AKP-ja që ta shqyrtojë vendimin e lartpërmendur që i referohet lëndës KPA00342. Ai ka sqaruar se sipas njohurisë së tij babai i tij e kishte blerë këtë “rrugë” në vitet e 70-ta dhe se që nga ajo kohë ajo ka qenë në shfrytëzim nga disa familje tjera. Ai nuk e dinte çmimin dhe nuk ka deklaruar se kishte pasur një kontratë me shkrim. Megjithatë, ai ka deklaruar se prona kishte qenë në shfrytëzim që nga vitet e 70-ta pa ndonjë vështirësi me familjen e paraqitësit të kërkesës. F.F. (tani e tutje: pala ankuese) nuk ka mundur të paraqes ndonjë dëshmi për pohimet e tij por ka njoftuar se do të dorëzojë për disa të tillë.

Dokumenti i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës (tani e tutje: pala përgjegjëse në ankesë) me 16 nëntor 2011. Pala përgjegjëse në ankesë nuk ka reaguuar.

Arsyetim ligjor:

Parashtesa e F.F. duhet të interpretohet si ankesë në Gjykatën Supreme pasi që kjo është mjet juridik i paraparë me ligj kundër vendimit të KKPK-së (neni 12 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 as të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079).

Ankesa është e pranueshme. Ndonëse pala ankuese nuk ka marrë pjesë në procedurë në shkallë të parë, Gjykatat e pranon ankesën e tij. Pasi që notifikimi i kërkesës është bërë vetëm me anë të publikimit (që sipas jurisprudencës së Kolegjit zakonisht nuk paraqet përpjekje të arsyeshme siç kërkohet me nenin 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut të ndryshuar me Ligin Nr. 03/L-079), pala ankuese jo domosdoshmërisht duhet të jetë në dijeni të kërkesës në datën e publikimit apo më vonë.

Pasi që Gjykata nuk gjen ndonjë kohë në të cilën mund të pohohet njohuria e palës ankuese rreth kërkesë, Gjykata në favor të palës ankuese gjen se ankesa është parashtruar brenda afatit të paraparë me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut të ndryshuar me Ligin Nr. 03/L-079.

Megjithatë, ankesa është e pabazuar

Pala ankuese nuk ka dhënë ndonjë dëshmi se ai apo babai i tij e kishin përfituar nga strëna, ai nuk i ka paraqitur Gjykatës ndonjë dokument apo deklaratë të dëshmitarëve. Se pala ankuese ishte informuar (si?) se prona ishte

blerë nga babai i tij mbetet vetëm një pohim i thjeshtë dhe nuk mund të mbizotëroj ndaj fakteve që i ka paraqitur paraqitësi i kërkesës (regjistrim i babai të tij në fletën poseduese nr. 184, vendim i mbi trashëgiminë që tregon se ai e kishte trashëguar 1/3 e pronës së regjistruar në fletën poseduese).

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me Shtojcën III, nenin 8.4 të Urdhërësës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Ndërkaq një përjashtim i tillë nuk parashikohet në procedurën para Kolegjit të Apelit. Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Apelit.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme të ankesës:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (Neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit (Nenet 10.21 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pas parasysh se vlera e pronës në fjalë me arsye mund të vlerësohet në 100 €: 50,50 € (50 + 0,5% e 100€).

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuese që ka humbur rastin. Në përputhje me nenin 45 paragrafin 1 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, taksat nga tarifa gjyqësore duhet të paguhen brenda 15 ditëve. Neni 47 paragrafi 3 parasheh se në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së tarifës. Nëse pala nuk i paguna taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë juridike

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it